



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

QENDRA NDËRINSTITUCIONALE E  
RRJETIT AKADEMIK SHQIPTAR

Nr. 3131 Prot. Tiranë, më 30.06.2022

Nr. 283 Prot. Tiranë, më 30.06.2022

**URDHËR I PËRBASHKËT**

Nr. 8, Datë 30/06/2022

**PËR MIRATIMIN E KALENDARIT PËR PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE TË  
REGJISTRIMIT NË INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, PËR VITIN AKADEMIK  
2022 – 2023**

Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 436, datë 03.06.2020, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, ose transferimin e studimeve në vitet e ndërmjetme të këtyre programeve, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2020-2021 dhe 2021-2022 e në vijim”, i ndryshuar dhe të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar,

**URDHËROJ**

1. Miratimin e kalendarit “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë për vitin akademik 2022 – 2023”, sipas shtojcës nr.1 dhe anekseve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij urdhri dhe që janë pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, Drejtoritë Rajonale dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**Për Qendrën e Shërbimeve Arsimore**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Znj. Aurora BALLIU**



**Për Qendrën Ndërinstitucionale  
të Rrjetit Akademik Shqiptar**

**Drejtor i Përgjithshëm**

**Z. Arjan XHELAJ**





Faint header text, possibly a title or reference number.

Faint text below the header, possibly a date or location.

Faint paragraph of text, likely the beginning of a letter or report.

Main body of faint text, containing several lines of illegible content.

Faint section header or sub-title.

Faint paragraph of text following the section header.

Faint paragraph of text, continuing the document's content.

Faint paragraph of text, possibly a closing or signature area.

Faint text on the left side, possibly a name or address.

Faint text on the right side, possibly a name or address.

Faint text on the left side, possibly a name or address.

Faint text on the right side, possibly a name or address.

Handwritten signature or initials in blue ink.

## SHTOJCA NR. 1

Periudha/Datat	
<b>Kreu II</b>	
<b>Procedurat e Aplikimit</b>	
<b>A. Procedurat e aplikimit. Raundi i parë</b>	
A. Procedurat e aplikimit Raundi i parë, <b>pika 3</b>	Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. PAGESA kryhet në periudhën <b>5 - 28 korrik 2022</b> . Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritetë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer brenda datës <b>28 korrik 2022</b> , në portalin U-Albania.
A. Procedurat e aplikimit Raundi i parë, <b>pika 4</b>	Në periudhën <b>29 korrik - 03 gusht 2022</b> , maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin U-Albania nëpërmjet formularit online të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas VKM përkatëse, si dhe kritereve të tjera të përcaktuara nga IAL, duke zgjedhur deri në <b>10 (dhjetë) programe studimi</b> nga lista e programeve të studimit që ofrohen nga IAL publike/jopublike, për vitin akademik përkatës.
<b>B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur. Raundi i parë</b>	
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 1</b>	Brenda datës <b>1 Korrik 2022</b> , QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z.
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 2</b>	Brenda datës <b>27 korrik 2022</b> , QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, të dhënat për çdo maturant/kandidat.
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 3</b>	Brenda datës <b>06 gusht 2022</b> , IAL që zhvillojnë konkurse/testime pranimit, shkarkojnë nga portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit.
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së	Në datën <b>06 gusht 2022</b> , të gjitha IAL që zhvillojnë konkurse/testime pranimit, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e



pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 4</b>	aplikantëve. Në periudhën <b>12-23 gusht 2022</b> do të zhvillohen konkurset e pranimit.
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 6</b>	Në datat <b>24 - 25 gusht 2022</b> , IAL mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre, listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur atë program studimi dhe të dhënat e tjera sipas udhëzimit.
B. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i parë, <b>pika 8</b>	Në datat <b>26 - 29 gusht 2022</b> , të gjitha IAL, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës <b>30 gusht 2022</b> , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
<b>C. Procedurat e aplikimit. Raundi i dytë</b>	
C. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, <b>pika 1</b>	Në periudhën <b>22 shtator – 24 shtator 2022</b> do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e dytë në Portalin U-Albania.
C. Procedurat e aplikimit. Raundi i dytë, <b>pika 3</b>	Deri më datë <b>10 shtator 2022</b> , nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hidhen në Portalin online të Maturantit të dhënat që lidhen me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.
C. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, <b>pika 5</b>	Maturantët/kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në Bankat e Nivelit të Dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Pagesa kryhet deri më <b>16 shtator 2022</b> . Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer brenda datës <b>17 shtator 2022</b> , në portalin U-Albania.
C. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, <b>pika 8</b>	Në datat <b>26 - 29 shtator 2022</b> , IAL afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës <b>29 shtator 2022</b> , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.



C. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, <b>pika 9</b>	Përshtatja e kuotave të paplotësuara në përfundim të raundit të parë nga IAL-të kryhet në datat <b>18 – 20 shtator 2022</b> . MAS konfirmon përshtatjen e kuotave dhe njofton IAL-të, RASH-in dhe QSHA, me datë <b>21 shtator 2022</b> .
<b>D. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur. Raundi i dytë</b>	
D. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i dytë, <b>pika 1</b>	Brenda datës <b>16 shtator 2022</b> , QSHA i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, të dhënat për çdo maturant/kandidat.
D. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i dytë, <b>pika 2</b>	Në datat <b>25 - 26 shtator 2022</b> , IAL shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre të dhënat e përcaktuara në pikën 2, germa D, kreu II të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, i ndryshuar.
D. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i dytë, <b>pika 4</b>	Në datat <b>26 - 29 shtator 2022</b> , IAL afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës <b>29 shtator 2022</b> , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
<b>E. Procedurat e aplikimit. Raundi i tretë</b>	
E. Procedurat e aplikimit Raundi i tretë, <b>pika 1</b>	Në periudhën <b>19 tetor – 21 tetor 2022</b> , do të kryhet procesi i aplikimit online për raundin e tretë në portalin U-Albania.
E. Procedurat e aplikimit Raundi i tretë, <b>pika 4</b>	Maturantët/kandidatët që nuk kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dymijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në Bankat e Nivelit të Dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë dhe do të aplikojnë në raundin e tretë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Pas dorëzimit të mandatit të pagesës, sekretaritë e shkollave konfirmojnë pagesën e kryer brenda datës <b>15 tetor 2022</b> , në portalin U-Albania.
E. Procedurat e aplikimit Raundi i dytë, <b>pika 4/1</b>	Përshtatja e kuotave të paplotësuara në përfundim të raundit të dytë nga IAL-të kryhet në datat <b>15 – 17 tetor 2022</b> . MAS konfirmon përshtatjen e kuotave dhe njofton IAL-të, RASH-in dhe QSHA-në me datë <b>18 tetor 2022</b> .



<b>F. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/kandidatëve të renditur. Raundi i tretë</b>	
F. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i tretë, <b>pika 1</b>	Në datat <b>22 - 23 tetor 2022</b> , IAL shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre të dhënat e përcaktuara në pikën 1, germa F, kreu II të udhëzimit nr.10, datë 15.05.2019, i ndryshuar.
F. Përcjellja e të dhënave dhe rezultateve, procesi i përlogaritjes së pikëve dhe publikimi i listave të maturantëve/ kandidatëve të renditur Raundi i tretë, <b>pika 3</b>	Në datat <b>23 - 26 tetor 2022</b> , IAL afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID-në e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës <b>26 tetor 2022</b> , IAL ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.
<b>Kreu III</b>	
<b>Procedurat e regjistrimit, çregjistrimit dhe ankimimit</b>	
<b>A. Procesi i regjistrimit. Raundi i parë</b>	
A. Procesi i regjistrimit Raundi i parë, <b>pika 1</b>	Në datat <b>2 deri 15 shtator 2022</b> (7 faza 48-orëshe; 02-03; 04-05; 06-07; 08-09; 10-11, 12-13 dhe 14-15), të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit, duke paraqitur dokumentacionin përkatës, në sekretariatë mësimore të IAL-ve, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
A. Procesi i regjistrimit Raundi i parë, <b>pika 7</b>	Në rast se, pas çdo faze, konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj mund të regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën <b>15 shtator 2022</b> .
A. Procesi i regjistrimit Raundi i parë, <b>pika 8</b>	Brenda datës <b>15 shtator 2022</b> , RASH përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara, në format elektronik dhe në hard-copy.
<b>B. Procesi i çregjistrimit. Raundi i parë</b>	
B. Procesi i çregjistrimit Raundi i parë, <b>pika 1</b>	Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin duke paraqitur dokumentacionin përkatës dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet në datat <b>16 - 17 shtator 2022</b> .
B. Procesi i çregjistrimit Raundi i parë, <b>pika 2</b>	Sekretariatë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i përcjellin në portalin U-Albania, në format elektronik brenda datës <b>18 shtator 2022</b> , listat e aplikantëve të çregjistruar.
<b>C. Procesi i ankimimit. Raundi i parë</b>	
C. Procesi i ankimimit Raundi i parë, <b>pika 1</b>	Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL përkatëse në datën <b>1 shtator 2022</b> .



C. Procesi i ankimimit Raundi i parë, <b>pika 2</b>	IAL, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik, në portalin U-Albania, më datë <b>2 shtator 2022</b> , vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve.
C. Procesi i ankimimit Raundi i parë, <b>pika 3</b>	Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, në datat <b>16 - 17 shtator 2022</b> .
<b>D. Procesi i regjistrimit. Raundi i dytë</b>	
D. Procesi i regjistrimit Raundi i dytë, <b>pika 1</b>	Në datat <b>03 tetor</b> deri <b>12 tetor 2022</b> (5 faza 48-orëshe; 03-04; 05-06; 07-08, 09-10 dhe 11-12), të gjithë aplikantët që kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, mund të kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL, duke paraqitur dokumentacionin përkatës në sekretaritetë mësimore, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
D. Procesi i regjistrimit Raundi i dytë, <b>pika 7</b>	Brenda datës <b>16 tetor 2022</b> , RASH përcjell në QSHA, në format elektronik dhe në hard-copy, regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë.
<b>E. Procesi i çregjistrimit. Raundi i dytë</b>	
E. Procesi i çregjistrimit Raundi i dytë, <b>pika 1</b>	Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin, duke paraqitur dokumentacionin përkatës dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datat <b>13 - 14 tetor 2022</b> .
E. Procesi i çregjistrimit Raundi i dytë, <b>pika 2</b>	Sekretaritetë mësimore, pas çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, i dërgojnë RASH-it, brenda datës <b>14 tetor 2022</b> , listën e aplikantëve të çregjistruar.
<b>F. Procesi i ankimimit. Raundi i dytë</b>	
F. Procesi i ankimimit Raundi i dytë, <b>pika 1</b>	Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit, përsa i përket raundit të dytë në IAL-në përkatëse, në datën <b>01 tetor 2022</b> .
F. Procesi i ankimimit Raundi i dytë, <b>pika 2</b>	IAL, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në RASH, më datë <b>02 tetor 2022</b> , vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve, si dhe i pasqyrojnë këto vendime, në format elektronik, brenda po këtyre datave, në portalin U-Albania.
F. Procesi i ankimimit Raundi i dytë, <b>pika 3</b>	Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, mund të vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit (nëse janë regjistruar) dhe të

	regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, vetëm në datat <b>13 - 14 tetor 2022</b> .
<b>G. Procesi i regjistrimit. Raundi i tretë</b>	
G. Procesi i regjistrimit Raundi i tretë, <b>pika 1</b>	Në datat <b>28 tetor</b> deri <b>02 nëntor 2022</b> (3 faza 48-orëshe; 28-29; 30-31 dhe 01-02), të gjithë aplikantët që kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e tretë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL, duke paraqitur dokumentacionin në sekretariatë mësimore, në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.
G. Procesi i regjistrimit Raundi i tretë, <b>pika 7</b>	Pas përfundimit të 3 (tri) fazave 48-orëshe të regjistrimit, në datat <b>03 nëntor</b> deri në <b>06 nëntor 2022</b> , IAL vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve, nëpërmjet portalit U-Albania, në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e tretë. <b>Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi dhe kanë aplikuar në raundin e tretë.</b> IAL, gjatë regjistrimeve, respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave.
G. Procesi i regjistrimit Raundi i tretë, <b>pika 7/1</b>	Pas përfundimit të raundit të tretë, kandidatët që janë pjesë e portalit U-albania dhe rezultojnë të peregjistruar në asnjë program studimi, kanë të drejtën e regjistrimit në programe studimi, ku ka kuota të paplotësuara në të gjitha IAL, pavarësisht aplikimeve në raundet e mëparshme, <b>në periudhën 07-08 nëntor 2022</b> .
G. Procesi i regjistrimit Raundi i tretë, <b>pika 8</b>	Brenda datës <b>16 nëntor 2022</b> , RASH përcjell në QSHA, në format elektronik dhe hard-copy, regjistrimet përfundimtare <b>të tri raundeve</b> .

**Kreu IV/1, IV/2, IV/3, IV/4, IV/5, IV/6**

*Shtojca nr. 1*

*Tabela 1: Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit sipas referencave në Udhëzim*

<i>Nr.</i>	<i>Referenca në Udhëzim</i>	<i>Afatet e përfundimit dhe datat e realizimit</i>
Kreu IV/1		
1	Kreu IV/1, pika 1	02.09.2022 – 13.09.2022
2	Kreu IV/1, pika 11	17.09.2022
3	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 1	23.09.2022
4	Kreu IV/1, pika 12, paragrafi 2	24.09.2022
5	Kreu IV/1, pika 14	27.09.2022



6	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 1	07.10.2022 – 11.10.2022
7	Kreu IV/1, pika 15, fjalia 2	18.10.2022
8	Kreu IV/1, pika 16	15.12.2022
Kreu IV/2		
9	Kreu IV/2, pika 1	02.09.2022 – 13.09.2022
10	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 1	13.09.2022
11	Kreu IV/2, pika 2, fjalia 3	16.09.2022
12	Kreu IV/2, pika 9	18.09.2022
13	Kreu IV/2, pika 11	26.09.2022
14	Kreu IV/2, pika 12	26.09.2022 – 03.10.2022
15	Kreu IV/2, pika 13	04.10.2022
16	Kreu IV/2, pika 14	10.10.2022
17	Kreu IV/2, pika 15	15.12.2022
Kreu IV/3		
18	Kreu IV/3, pika 1	Sipas afateve të përcaktuara nga IAL-të
19	Kreu IV/3, pika 2/1	Dhjetor 2022
20	Kreu IV/3, pika 6	13.09.2021
21	Kreu IV/3, pika 8	16.09.2022
22	Kreu IV/3, pika 9	18.09.2022
23	Kreu IV/3, pika 10	26.09.2022
24	Kreu IV/3, pika 11	24.01.2023
Kreu IV/4		
25	Kreu IV/4, pika 1	deri më 18.10.2022
26	Kreu IV/4, pika 2	03.11.2022
27	Kreu IV/4, pika 4	17.11.2022
28	Kreu IV/4, pika 5	19.11.2022
29	Kreu IV/4, pika 8, shkronja "b"	Dhjetor 2022
30	Kreu IV/4, pika 16	21.12.2022
Kreu IV/5		
31	Kreu IV/5, pika 1	deri më 04.11.2022
32	Kreu IV/5, pika 18	06.11.2022

33	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 1	10.11.2022
34	Kreu IV/5, pika 19, Paragrafi 2	11.11.2022
35	Kreu IV/5, pika 21	13.11.2022
36	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 1	14.11.2022 – 18.11.2022
37	Kreu IV/5, pika 22, fjalia 2	19.11.2022
38	Kreu IV/5, pika 23	21.12.2022
Kreu IV/6		
39	Kreu IV/6, pika 1	deri më 18.10.2022
40	Kreu IV/6, pika 2	29.10.2022
41	Kreu IV/6, pika 4	deri më 13.11.2022
42	Kreu IV/6, pika 5	deri më 13.11.2022
43	Kreu IV/6, pika 8, shkronja "b"	Dhjetor 2022
44	Kreu IV/6, pika 16	21.12.2022



## Aneksi 1

Kalendari i renditjes dhe regjistrimit të kandidatëve për IAL

	Procesi	Kohëzgjatja	Periudha
<b>RAUNDI 1</b>	IAL shkarkojnë të dhënat për programet me konkurse	1 ditë	05.08.2022
	IAL zhvillojnë konkurse	12 ditë	12.08.2022 - 23.08.2022
	IAL shkarkojnë të dhënat e aplikantëve	2 ditë	24.08.2022 -25.08.2022
	Renditja dhe ngarkimi nga IAL	4 ditë	26.08.2022 - 29.08.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	31.08.2022
	Ankimimet në IAL	1 ditë	01.09.2022
	Ndryshimi i renditjes ne U-Albania pas ankimimeve	1 ditë	01.09.2022
	Regjistrimi në U-Albania (7 faza 48-orëshe)	14 ditë	02.09.2022 – 15.09.2022
	Çregjistrimi (Raundi 1) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	16.09.2022 - 17.09.2022
<b>RAUNDI 2</b>	IAL shkarkojnë të dhënat e aplikantëve	2 ditë	25.09.2022 -26.09.2022
	Renditja dhe ngarkimi nga IAL	4 ditë	26.09.2022 – 29.09.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	30.09.2022
	Ankimimet në IAL	1 ditë	01.10.2022
	Ndryshimi i renditjes ne U-Albania pas ankimimeve	1 ditë	02.10.2022
	Regjistrimi në U-Albania (5 faza 48-orëshe)	10 ditë	03.10.2022 - 12.10.2022
	Çregjistrimi ( Raundi 2) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	13.10.2022 - 14.10.2022
<b>RAUNDI 3</b>	IAL shkarkojnë të dhënat e aplikantëve	2 ditë	22.10.2022 -23.10.2022
	Renditja dhe ngarkimi nga IAL	4 ditë	23.10.2022 - 26.10.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	27.10.2022
	Regjistrimi në U-Albania (3 faza 48-orëshe)	6 ditë	28.10.2022 – 02.11.2022
	Kërkesë dhe Regjistrimi në sekretaritet mësimore të njëjësive kryesore (fakultet), në programet e studimit në të cilat nuk kanë fituar në raundin e tretë	4 dite	3.11.2022 - 6.11.2022

## Aneksi 2

Kalendari i aplikimit dhe regjistrimit për maturantët në IAL

	Procesi	Kohëzgjatja	Periudha
<b>RAUNDI 1</b>	Aplikimi - Pagesë tarife	26 ditë	05.07.2022 - 28.07.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	6 ditë	29.07.2022 - 03.08.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	31.08.2022
	Ankimimi	1 dite	01.09.2022
	Regjistrimi në IAL / Publikimi ne kohe reale i renditjes (7 faza 48-orëshe)	14 ditë	02.09.2022 - 15.09.2022
	Çregjistrimi (Raundi 1) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	16.09.2022 -17.09.2022
<b>RAUNDI 2</b>	Aplikimi - Pagesë tarife	16 ditë	02.09.2022 - 16.09.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	3 ditë	22.09.2022 - 24.09.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	30.09.2022
	Ankimimi	1 ditë	01.10.2022
	Regjistrimi në IAL/ Publikimi ne kohe reale i renditjes (5 faza 48-orëshe)	10 ditë	03.10.2022 - 12.10.2022
	Çregjistrimi (Raundi 2) / regjistrim i fituesve pas ankimimit	2 ditë	13.10.2022 - 14.10.2022
<b>RAUNDI 3</b>	Aplikimi - Pagesë tarife	15 ditë	01.10.2022 - 15.10.2022
	Aplikimi Online - Përzgjedhja e 10 programeve të studimit	3 ditë	19.10.2022 - 21.10.2022
	Publikimi i renditjes së aplikantëve në U-Albania	1 ditë	26.10.2022
	Regjistrimi në IAL/ Publikimi ne kohe reale i renditjes (3 faza 48-orëshe)	6 ditë	28.10.2022 – 02.11.2022
	Kërkesë dhe Regjistrimi në sekretaritë mësimore të njëjësive kryesore (fakultet), në programet e studimit në të cilat nuk kanë fituar në raundin e tretë	4 ditë	03.11.2022 – 06.11.2022
Kërkesë dhe Regjistrimi pranë IAL-ve, pavarësisht aplikimeve në tre raundet në portalin U-Albania	2 ditë	07.11.2022 – 08.11.2022	